



Drejtoria e Arsimit

04/Nr. 126

Me:12/07/2018

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 62 paragrafi 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 20 dhe 22 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve komunale Nr.01-011-11268 i dt.07.07.2014 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Gjakovës, Drejtori i Drejtorisë për Arsimit shpall:

KONKURS PLOTËSUES

PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

- I. Komuna e Gjakovës ka planifikuar të ndaj 50 (pesëdhjetë) bursa për vitin akademik 2017/2018, me ç'rast në konkursin e parë 04/Nr.128 të dt.04/05/2018 kanë përfituar 42 (katërdhjetë e dy) studentë të cilët i kanë paraparë në konkurs, andaj Drejtoria e Arsimit shpall konkurs plotësues edhe për 8 (tetë) bursa për studentë të cilët studiojnë në Universitetet Publike të Kosovës, për vitin akademik 2017/2018, në këto fusha studimi:

1. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike 2 bursa

2. Fakulteti i Mjekësisë 4 bursa

- Drejtimi Mjekësi e Përgjithshme - 3 bursa
- Drejtimi Stomatologji - 1 bursa

3. Fakulteti i Shkencave Matematiko – Natyrore 2 bursa

- Drejtimi Matematikë - 1 bursë
- Drejtimi Fizikë - 1 bursë

II. Vetëm studentët/et që janë banorë të komunës së Gjakovës, pa kurrfarë dallimesh etnike, gjinore, fetare dhe politike, që janë të regjistruar në fakultete të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, duke përjashtuar studentët në studime pasuniversitare – master dhe doktoratë, kanë të drejtë të konkurrojnë për ndarjen e bursave të studimeve.

III. Kriteret për ndarjen e bursave janë:

- a. Nota mesatare prej 9 – 10 në fakultete ose suksesi i shkëlqyeshëm20 pikë
- b. Fëmijët pa prind (Fëmijët e Dëshmorëve, Martirëve dhe Invalidëve të Luftës).. ..25 pikë

- c. Nota mesatare prej 8 – 9 në fakultete ose suksesi shumë i mirë15 pikë
- d. Nota mesatare prej 7 – 8 në fakultete ose suksesi i mirë10 pikë
- e. Personat me aftësi të kufizuara15 pikë
- f. Rastet me gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale15 pikë

Në kushtet e barabarta të vlerësimit të kriterëve të përshkruara në nenin 22.1 të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve të komunës me nr.01-011-11268 i dt.07.07.2014 përparësi kanë fëmijët e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve të luftës, viktimave të luftës dhe të familjeve që kanë dy apo më tepër studentë.

Studentët e vitit të parë vijnë në konsideratë nëse nuk plotësohen vendet nga viti i dytë deri në të gjashtin si dhe 2 bursa të së njëjtës familje nuk i ndahen për një vit akademik.

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Aplikacioni sipas formës së Komunës;
2. Kopja e ID-ës së studentit;
3. Vërtetimi se studenti ka regjistruar vitin akademik 2017/2018 (origjinale);
4. Certifikata e notave (origjinale);
5. Vërtetimi që studenti nuk është përfitues i bursës nga Universiteti apo Ministria e Arsimit (origjinale);
6. Certifikata / Ekstrakti i lindjes;
7. Deklarata e bashkësisë Familjare
8. Certifikata për përfundimin e shkollës mesme të lartë (kopje). Çdo aplikacion në mungesë të këtij dokumenti do të konsiderohet se nuk është banor i Komunës së Gjakovës më tepër se 10 vite;
9. Kopja e letërnjoftimit
10. Vërtetimi nga Administrata Tatimore që nuk jeni në marrëdhënie pune.

Për anëtarin e ngushtë të familjes së dëshmorëve edhe:

11. Vendimi/ Vërtetimi se është anëtar i ngushtë i familjes së dëshmorëve;

Për anëtarin e ngushtë të familjes në asistencë sociale edhe:

- 11.Vendimi / Vërtetimi që dëshmon se aktualisht është shfrytëzues i ndihmës sociale (origjinale);

Për studentët e regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2017/2018 edhe:

- 12.Kopjet e vërtetuara të dëftësave dhe të diplomës për përfundimin e shkollës së mesme

Për studentët me nevoja të veçanta:

1. Vendimi / Vërtetimi zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Vërejtje : Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit zyrtar nuk do të shqyrtohen.

Për përzgjedhjen e përfituesve të bursës komunale Drejtoria për Arsim në Gjakovë e formon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e bursave dhe pas mbylljes së afatit të konkursit, ky komision në bashkëveprim me Drejtorin e kësaj drejtorie, e kryen procesin e shqyrtimit të

kërkesave dhe e harton raportin e punës, të cilin më rekomandime përkatëse ia përcjell Kryetarit për miratimin e vendimeve për ndarjen e bursave.

Kandidatëve të cilëve iu ndahet bursa për kushtet e shfrytëzimit do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohen kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e shpalljes në tabelën e shpalljeve në Drejtorinë e Arsimit, në mjetet e informimit publik dhe në webfaqen www.gjakovaportal.com. Konkursi mbetet i hapur prej dt.12/07/2018 e deri me dt.19/07/2018.

Aplikacioni i kërkesës merret në Drejtorinë e Arsimit në Gjakovë dhe i plotësuar dorëzohet në zyrën për pranim dhe arkiv në komunën e Gjakovës çdo ditë pune prej orës 10:00 deri 15:00.

Vërejtje: Kandidatët të cilët kanë aplikuar në konkursin e parë 04/Nr.128 të dt.04/05/2018 nuk kanë nevojë që të aplikojnë përsëri në konkursin plotësues të dt.12/07/2018 sepse të njëjtat dokumente janë valide dhe do të shqyrtohen nga komisioni i bursave.

Me respekt !

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit
Bernard Errokaj

